MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN KARINË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Karinë me objekt: "Mbi vlerësimin e e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomiko e financiar, procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e studimeve, shesheve e lejeve të ndërtimit, administrimit e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë së komunës etj." për periudhën 01.01.2009-31.12.2011 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 62, datë 15.05.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 298/5, datë 15.05.2012, dërguar **z. Selman KARINA**, Kryetar i Komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Të miratohet në Këshillin e Komunës struktura dhe organika e re e administratës, bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" me ndryshime, neni 32, shkronja ç, e cila të jetë e argumentuar dhe funksionale, si dhe të merren masa që në pozicionet e Përgjegjësave të Zyrave të emërohen specialist të lartë të fushave përkatëse.

   Menjëherë

2. Të lidhen kontratat individuale të punës me punonjësit, të mbahet regjistri përkatës i tyre dhe të hartohet e miratohet në Këshillin e Komunës, Rregullorja e Brendshme e Komunës, bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" me ndryshime, respektivisht, nenet 21, 11 dhe 36.

   Deri me datë 30.06.2012

3. Të bëhet regjistrimi i pasurive të paluajtshme, të miratuara me VKM nr 763, datë 28.5.2008 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Karinë të Qarkut të Elbasanit", në Zyrën e Regjistrimin të Pasurive të Paluajtshme, sipas listës përkatëse.

   Brenda vitit 2012

4. Të verifikohet periudha e përfitimit të ndihmës ekonomike e z. I. D. , dhe nëqoftëse ai vazhdon qëndrimin jashtë shtetit, të hiqet nga skema e trajtimin me ndihmë ekonomike bazuar në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" me ndryshime.

   Menjëherë

5. Të hiqen nga përdorimi mandatarkëtimet dhe mandatpagesat pa numër serial, ndërsa arkëtimi i taksave vendore të kryhet vetëm nga arkëtari në arkën e Komunës.

   Menjëherë

6. Të riorganizohet Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me specialist të fushës, sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", kreu V-të, pika 1 shkronja b, dhe pika 2 shkronja ç.

   Menjëherë

7. Të ngrihet një grup pune me specialist të fushës, për vlerësimin real të autoveturës së blerë sipas kontratës së lidhur më datë 19.08.2009, duke u bazuar në vlerësimin doganor

në datë e hyrjes në Shqipëri dhe nëse rezultojnë diferenca krahasuar me çmimin e blerjes, të ngarkohen me përgjegjësi konform ligjit personat që kanë kryer procedurat e blerjes.

Menjëherë

8. Në kontratat e sipërmarrjeve të ndërtimit, për objektet që kanë afat përdorimi të gjatë, afati i garancisë të vendoset në përputhje me nenin 866, të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" me ndryshime, jo më pak se 10 vjet.

Vazhdimisht

9. Të rishikohet me mirëkuptim të ndërmjet palëve, ose në rrugë gjyqësore, aktmarrëveshja nr. 2, datë 07.12.2007, e lidhur ndërmjet Bashkisë Peqin dhe Komunës Karinë, me objekt: "Kryerja e funksioneve të Inspektoriatit Ndërtimor më Juridiksionin e Komunës, nga Inspektoriati Ndërtimor i Bashkisë Peqin", dhe ky funksion t'i kalojë Këshillit të Qarkut Elbasan, bazuar në ligjin nr. 9870, datë 16.7.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", nenet 4 dhe 6.

Menjëherë

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Pal Gjoni, Hekuran Avdulaj. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT